



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:226048
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05471170

CP.nr.1847/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, përmes gjyqtarit individual Fuad Haliti dhe me bashkëpunëtorin profesional Eron Prekazi, në lëndën përbarimore të kreditorit Xh.U nga Mitrovica, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Vehbi Halili, avokat me seli në Prishtinë, ndaj debitorit Trepça Sh.A, me seli në Mitrovicë, që zhvillohet në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, jashtë seancës gjyqësore me datë 19.03.2024, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDOHET procedura përbarimore e kreditorit Xh.U nga Mitrovica, ndaj debitorit Trepça Sh.A, me seli në Mitrovicë.

Arsyetim

Me aktvendimin e kësaj gjykate CP.nr.1847/2021 e datës 08.06.2022 është caktuar përbarimi sipas propozimit të kreditorit Xh.U nga Mitrovica, ndaj Trepça Sh.A, me seli në Mitrovicë.

Me emailin e datës 15.03.2014, NLB Bank e ka njoftuar se ky aktvendim është ekzekutuar pagesa dhe avokati i kreditorit ka pranuar pagesën.

Gjykata duke u bazuar në nenin 66 i LPP-së, i cili flet për përfundimin e procedurë përbarimore ma saktësisht par. 4 i po të njëjtit nen thotë citoi “Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxjerret vendim për përfundimin e procedurës përbarimore”, e nga të lartëcekurat pasiqë borxhi është paguar në tërsi e PËRFUNDOJ procedurën përbarimore.

Nga arsyet e cekura si më lartë, e konform nenit 66 paragrafi 4 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përbarimore) është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
CP.nr.1847/2021, datë 19.03.2024

GJYQTARI
Fuad Haliti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditore nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.